



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 1383 Mb
Br. prot. Dt. 02.04.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORTI 3-MUJOR I PUNËS

JANAR, SHKURT, MARS 2026



2026

Aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2026

- Gjate kësaj periudhe kemi pasur intervenime ne disa zona për ndriçim publik, sidomos ne drejtimin e shtyllave te ndriçimit publik, si dhe pjese tjera te nevojshme për intervenim, sidomos ne mirëmbajtje, ne rregullim te ujëmbledhëseve, pusetave, rruge te dëmtuara, si dhe intervenime te tjera qe janë te domosdoshme ne infrastrukture,
- Intervenimet emergjente ne deblokimin e rrugëve janë bere: ne Kaznik, ne Fortese, Brestoc, Pastasel, Kramavik, Xerxe, po ashtu ka pasur aktivitete për pastrim te rrugëve dhe trotuareve, pas vërshimeve qe ka pasur ne muajin janar,
- Gjate muajit janar ka pasur aktivitete te mbledhjes se mbeturinave ne disa rruge te komunës sonë,
- Janë trajtuar edhe probleme tjera si rregullimi i kabllorse për kamerat e sigurisë, vendosja e tabelave,
- Është dorëzuar ne MMPHI, lista e përroskave te komunës sonë qe kane nevojë për ndërhyrje, kryesisht ne pastrim,
- Është përfunduar vlerësimi vjetor për stafin e drejtorisë për vitin 2025 sipas ligjit,
- Janë trajtuar 47 lende ne intranet,
- Gjate kësaj periudhe kemi filluar me heqjen e deponive ilegale (Fortese, rruga rajonale Rahovec-Suhareke, ne rrugën Sarosh-Pastasel)
- Është perfunduar krasitja e drunjtëve dekorative ne qytet dhe ne vende tjera ku është rritur vegjetacioni,
- Ka përfunduar rregullimi i trotuarit ne rrugën “Vëllezërit Haradinaj”,
- Kane filluar punimet ne rrugën Sarosh ne drejtim te Rahovecit, po behet nën baza e rrugës, me pastaj punimet tjera sipërfaqësore,
- Po ashtu ne rrugën 4 korsi po vendosen pikat për fillimin e punimeve ne largimin e rrjetit elektrik nga rruga, janë duke vendosur shenjat për largimin e shtyllave,
- Kane vazhduar punimet ne rrugën Sapniq-Nashpall-Vrajak, kane mbetur edhe disa pozicione te lëshesave gypore me pastaj asfaltimi i rrugës,
- Janë hequr deponite ilegale te mbeturinave ne rrugën e Hamocit dhe rrugën Transite,
- Po vazhdon pastrimi i kanaleve dhe pastrimi i përroskës ne fshatin Malësi e Vogël, Xerxe, Zoqishtë dhe vendbanime te tjera sipas nevojës,
- Janë vendosur te dhënat në sistem të performances nga DSHP,
- Janë përfunduar per muajin janar, shkurt, mars te gjitha kërkesat e adresuara ne DSHP përmes platformës Intranet,
- Janë përfunduar 6 gropa septike, një projekt i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian përmes programit IPA ne partner komuna e Haraqines, Maqedoni e Veriut.

Sfidat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike për vitin 2026:

- Sfidat e Drejtorisë janë kërkesat e shumta për ndërtimin e rrugëve lokale, si dhe për rrugë dytësore dhe të pakategorizuara;
- Sfidë e radhës që vazhdimisht na ka përcjellë gjatë këtyre viteve janë mbeturinat e amvisërisë dhe ato inerte që fatkeqësisht hidhen kudo, ku krijohen deponi ilegale, Komuna e Rahovecit çdo vit mirëmban hapësirat publike, por ato prapë hidhen kudo;
- Furnizimi me ujë të pijshëm për ato vende që ende nuk kanë të shtrirë rrjetin e K.R.U. "Gjakova".
- Rregullimi dhe furnizimi me energji elektrike, rigjenerimi i rrjetit të ri dhe kërkesa të shumta që adresohen nga qytetarët.

Drejtori i DShP-së

Përparim Krasniqi

